



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3136 Prot.

Roskovec, më 01, 07 2020

VENDIM

NR 48 .DATË 29.06 .2020

**“PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
QË NDODHEN NË TERRITORIN E BASHKISË ROSKOVEC”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k); Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) neni 6, pika 2, gërma b); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, neni 37 pika 1; Ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, gërma c, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, VKM nr. 770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Bashkisë Roskovec, Qarku Fier**” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr.22, datë 20.02.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në listën përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat janë në territorin e Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit, me Vkm nr.770, datë 24.09.2010” Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Përditësimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Roskovec të miratuar me VKM nr.770 datë 24.09.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Bashkisë Roskovec, Qarku Fier**" dhe Vendim të Këshillit të Bashkisë Nr.22 ,datë 20.02.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në listën përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat janë në territorin e Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit, me Vkm nr.770, datë 24.09.2010”
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.



KRYETAR
Kadri Hyska